



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 24.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 21.01.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIACION SHPK&NAZERI 200 SHPK DEGA NE KOSOVE" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211** nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIACION SHPK&NAZERI 200 SHPK DEGA NE KOSOVE" e datës 21.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211** kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 20.01.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues** i publikuar me datë: 20.01.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë respektimin e Vendimit të datës 20.01.2020
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIACION SHPK&NAZERI 200 SHPK DEGA NE KOSOVE" me datë 21.01.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.01.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsye në vijim:

-Pretendimi i parë lidhur me mosrespektimin e Vendimit të OSHP-se është plotësisht i pa bazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues në rivlerësim nuk i ka trajtuar si kritere të vlerësimit orët

e nates dhe numrin e punetoreve, pasi qe me ate Vendim dhe nga ekspertiza jane konsideruar si kriteret te pa matshme;

-Poashtu pretendimi juaj per kalkulim te pages eshte i pa bazuar pasi qe kalkulimi nga komisioni i AK-se eshte bere ne pajtim me Vendimin e OSHP-se dhe interpretimin e ATK-se lidhur me kalkulimin e pages. Kalkulimi eshte bere per ore pune mujore, pasi qe Vendimi i OSHP-se ka rekomanduar qe te mos merren parasysh ne vleresim numri i punetoreve dhe nderrimet e nates, pasi qe nga pershkrimi i çmimeve kjo nuk mund te matet dhe saktësohet. Bazuar ne kete siqe mund te shihet edhe nga raporti i vleresimit kalkulimi eshte bere sipas dispozitave ligjore dhe jane marre per baze vetem kriteret qe jane konstatuar si te matshme dhe çmimi minimal per ore pune duke marre parasysh vetem dy kriteret e matshme ne kete rast nga detyrimet ligjore; festat zyrtare dhe pushimin vjetor ka rezultuar se çmimi per ore pune (duke llogaritur edhe TVSH-ne) eshte 1.91 euro.

Nr. rendor	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
ORARI I PUNES 16:00 - 24:00				
1		paga minimale bruto		
2	paga minimale EURO	250		250.00
3	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet
4	total ore pune sipas ligjit per nje muaj	176 ore mesatare gjate muajit		
5	ore dite - cmimi normal	176	1.42	250.00
6	ore festave - 50%	5.24	0.71	3.72
7	pushim vjetor max. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.42	18.94
	paga per nje punetor ne muaj			285.16
	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			1.62
			TVSH	0.29
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			1.91

Bazuar ne kete kalkulim te ligjshem rrjedh se çmimi juaj prej 1.70 euro per ore nuk mjafton as vetem per pagen bruto prej 250 euro pa kalkuluar asnje detyrim tjeter ligjor dhe te njejtin e paraqesim ne vijim:

#	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
ORARI I PUNES 16:00 - 24:00				
		paga minimale bruto		
	paga minimale EURO	250		250.00
	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet

	total ore pune sipas ligjit per nje muaj	176 ore mesatare gjate muajit		
	ore dite - cmimi normal	176	1.42	250.00
	Kontributi pensional I kompanise (5% punedhenesi)			12.50
	paga per nje punetor ne muaj			262.50
	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			1.49
			TVSH	0.27
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			1.76

-Pretendimi se OE-ik i rekomanduar per dhenje te kontrates eshte shpall i pa pergjegjshem nga Vendimi i OSHP-se eshte i pa vertete dhe i pa bazuar e qe mund ta konstatooni edhe nga teksti i Vendimit qe ju e keni cituar nje pjese te te cilit ua paraqesim ketu: "...atehere nuk mund te deshmohet se ky grup i OE-ik ka ofruar deshmi te mjaftueshme se ka kontrata te implementuara ne vlere minimale prej 3.000,000.00 euro,pa bere sqarime shtese ne veçanti rreth vleres se kontratave te realizuara nga anetaret e konzorciumit "Aulona-Pol-1 SHPK dhe "Comando SHPK",ne tri vitet e fundit."Pikerisht bazuar ne kete jane kerkuar sqarime nga ky Grup i OE-ik dhe i njeiti ka ofruar deshmi te mjaftueshme e te cilat jane paraqitur edhe ne Raportin e Rivleresimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet e dhena ne Raportin e rivleresimit vendosi si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit